



BANKA POPULLORE E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË

Në bazë të nenit 47 paragrafi 1 pika 6 të Ligjit për Bankën Popullore të Republikës së Maqedonisë ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 158/2010) dhe nenit 27 paragrafi 3 të Ligjit për mbrojtjen e konsumatorëve gjatë marrëveshjeve për kredi konsumatore ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 51/2011), Këshilli i Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë miratoi

VENDIM

**për dorëzimin e listës së ndërmjetësimit të kredisë
(„Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë " nr. 91/2011)**

I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1. Me këtë vendim përcaktohet mënyra dhe procedura sipas të cilave banka është e obliguar te Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë (në tekstin e mëtejme: Banka Popullore) të dorëzojë listën e ndërmjetësimit kreditor të cilëve u ka dhënë autorizim për ndërmjetësues kreditor.

II. LISTA E NDËRMJETËSUESVE TË KREDIVE

2. Banka është e obliguar, më së voni deri më 31 mars të vitit aktual, deri te Banka Popullore të dorëzojë listën e ndërmjetësve të kredisë (formulari KP), e cila është pjesë përbërëse e këtij vendimi.

Në listën e ndërmjetësuesve të kredisë, banka shënon të gjithë ndërmjetësit e kredisë të cilëve u ka dhënë autorizimin me shkrim për ndërmjetësim, së bashku me të dhënat për llojin dhe vëllimin e aktiviteteve të secilit prej ndërmjetësve të kredisë gjatë vitit kalendarik të kaluar.

3. Me kërkesë të posaçme të Bankës Popullore, banka është e detyruar të dorëzojë formularin e KP-së për periudhë ndryshe nga periudha nga pika 2 paragrafi 1 i këtij vendimi.

III. DISPOZITA KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

4. Dispozitat e këtij vendimi që u referohen bankave zbatohen edhe për kursimoret dhe filijalet e bankave të huaja në Republikën e Maqedonisë.
5. Me fillimin e zbatimit të këtij vendimi, pushon të vlejë vendimi për dorëzimin e listës së ndërmjetësve kreditor ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 42/2011).

6. Ky vendim hyn në fuqi ditën e tetë nga dita e publikimit në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë", dhe do të fillojë të zbatohet prej 01.10.2011.

**O nr. 02-15/VII-3/2011
30.06.2011
Shkup**

**Guvernator
dhe kryesues
i Këshillit të Bankës Popullore të
Republikës së Maqedonisë
Димитар Богев**